

**VENDIM**  
**Nr. 760, datë 12.11.2014**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 439, DATË 2.7.2014, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË LEGALIZIMIT TË**  
**NDËRTIMEVE PA LEJE, SHITESAVE ANËSORE APO NË LARTËSI, TË**  
**NDËRTUARA NGA SHOQËRIA “HAWAI-ALB” SHPK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 43/1, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Pas pikës 4, të vendimit nr. 439, datë 2.7.2014, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 4.1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Kur trualli mbi të cilin është ngritur objekti bazë ose shtesa anësore/në lartësi, apo një pjesë e tij, rezultojnë në pronësi shtetërore, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme, kalimi i pronësisë mbi sipërfaqen përkatëse kryhet pa pagesë, në mbështetje të neneve 3, pika 4, e 4, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pasuritë e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 761, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**